

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE “AGRO IMPORT EKSPORT PERONDI ” shpk

Në këtë statut

“Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008“PërTregtarëdhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;

“Statuti”ështëStatuti i shoqërisë;

Kreul

Themelimi,Emri,Objekti,Kohëzgjatja,Selia

Neni1:Data e Themelimit,EmridheThemeluesit

Sot,më 05 Gusht 2022, me cilësinë e themeluesit, kam krijuar shoqërinë me përgjegjësi tëkufizuar,me emrin“**AGRO IMPORT EKSPORT PERONDI” shpk**

Themeluesi i e shoqërisë është z.Marsel Hoxha , e indentifikuar me ID(nr.personal) J40424005B, lindur ne Kucove dhe banuese në lagjjen “Murat Daulle” ,Fshati Magjate,Njesia “Administrative Perondi “ .

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Import- eksport i prodhimeve bujqësore , prodhimeve blegtorale , pemptarisë, ullirit, agrumeve, vreshtarisë etj.

Perpunimi i prodhimeve bujqesore , dhe blegtorale

Tregtimi me shumicë dhe pakicë plehra kimike, koncentrate per blegtorine dhe shpendet, artikuj te ndryshem ushqimore dhe plastike, vegla pune, makineri te ndryshme bujqesor

Çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj, brenda parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e papërcaktuar.

Neni 4:Selia

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Fshati Perondi ”, Nr pasurie 1055/17 , Zona kadastrale nr.2918, Njesia “ Administrative Perondi “**

(2)Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është do te hapet me krijimin e shoqerise.

(3)Adresa e shoqërisë,për qëllime komunikimi elektronikë shtë: marselhoxha1994@gmail.com

Kreu II Kapitali

Neni 5:Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i regjistruar i shoqërisë, është 100.000 lekë.

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e regjistruar tëshoqërisë është në përputhje me

kontributin, sime më poshte:

Ortaku themelues Marsel Hoxha ,është zoteruesi 1 (një)kuote,me vlerë të përgjithshme 100.000 lekë,që përben 100% tëkapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut eshte në para dhe do te depozitohet ne llogarite bankare te shoqerise me marrjen e statusit juridik.

Neni 6: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ne permjet nënshkrimeve të pjesë vetë kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per kete kontribut sipas kerkeses se administratorit Në asnjë rast shumica nukmund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlim i i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve,ecila merr vendim në tënjëjtat kushte që kërkohen përndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesë vetë kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7:Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të njëshoqërie me përgjegjësi të kufizuar etë drejtat qërrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen npërmjet:

kontributit në kapitalin eshoqërisë;

shitblerjes;

trashëgimisë;

dhurimit;

çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesë te kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve,për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesëte kapitalit themeltar janë lirisht tëtransferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIM MARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8: Organi Vendim marres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakevee shteo rgani i vetem vendim marresi shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalite te vetete percaktuara ne ligj.

Asambleja epërgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështje të mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e ilikuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- f) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e ortakëve e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të vepron në sipërfaqësues i ortakëve në asamblesë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9: Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'udërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10: Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmë në numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11: Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërta të votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-se për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12: Përfshirja nga e drejta e votës

(1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja

(2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13: Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorë të një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) **Administratori i parë të shoqërisë është z. Marsel Hoxha e indentifikuar me ID(nr.personal) J40424005B, lindur Kuçovë dhe banues në Fshatin Magjate , Njesia Administrative "Perondi " , me afat emërimi 5 vjet dhe me të drejtë riemërimi.**

Neni 14: Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke

- zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratores janë të detyruar të thetasin Asamblesë së Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktive të shoqërisë nuk i mbulojnë detyrime të kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkëri sht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënies kontraktore meshoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15: Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasoja të marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që isjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
2. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

3. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
4. të parandalojë dhe mënjanojë rastete konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
5. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
6. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
7. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1e2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të
8. vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
9. Në Mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet të shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprime të mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d)
 - e) ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - f) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që ingarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose sebashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendimi i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabime të kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16: Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 7: Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë

ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij pe rrastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille ingarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabe i autorizuar pergatit raportin me shkrim pe nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara,të cilat eshte idetyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja–riorganizimi i shoqërisë

Neni18: Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohë zgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723,datë3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyre ne likuidimit të shoqërise, duke caktua 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese“ Shoqërine likuidime siper“.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese,me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesite emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve,brenda 30 ditëve pas prishjes,çdo personi i nteresuar mund t'i drejtohet gjykatës,për të caktuar një likuidues.

Neni 19:Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet ,bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së PërgjithshmetëAsamblesës së Ortakëve,në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë14.04.2012“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”, i ndryshuar.

Neni 20: Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit"Per tregtarët dheshoqërite tregtare",Kodit Civil dhe çfare do ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21: Mosmarrëveshjet

Per mos marreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti ,si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindre midis Shoqerise dhe te treteve ,do teje te kompetente Gjykata Shqiptar.

Kucove me 04 Korrik 2022

ORT AKU THEMELUES

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TËKUFIZUAR

“AGRO IMPORT EKSPORT PERONDI ” shpk

Marsel Hoxha

